

PAGESAT ME KARTË PO RRIJEN, POR KOSTOT MBETEN FAKTOR FRENUES

Turizmi ka qenë faktor kyç në rritjen e pagesave me kartë, por megjithatë kostot ngelen një nga pengesat kryesore për zgjerimin e mëtejshëm të tyre në ekonominë shqiptare. Fatbardha Rino, Drejtore e Divizionit Retail në Union Bank, thotë në një intervistë për “Monitor” se për bankat, biznesi i kartave dhe pagesave në POS ka kosto shumë të larta procesimi dhe pothuajse asnjëherë nuk e mbulojnë këtë kosto me çmimet që u ofrojnë bizneseve.

Sipas saj, kjo situatë çon në një stepje të bankave për të zhvilluar më shumë këtë instrument pagese. Kjo gjë mund të vihet re dhe në strukturën e tregut të POS-eve, ku vetëm pak banka mbajnë pjesën dërrmuese. Faktorë të tjerë që frenojnë rritjen e pagesave me kartë, sipas znj. Rino, janë kultura dominuese e parasë cash, mungesa e edukimit të mjaftueshëm të publikut për avantazhet e pagesave me kartë, mungesa e politikave që stimulojnë pagesat jocash dhe mungesa e një sistemi kombëtar të procesimit të pagesave me kartë.

Statistikat tregojnë rritje të lartë të pagesave me kartë në терминаlet POS vitin e kaluar dhe në gjysmën e parë të këtij viti. Cilat janë arsytet që po ndikojnë në rritjen me ritme të larta të pagesave me kartë?

Rritja e pagesave me kartë është një zhvillim mjaft pozitiv, pra klientët gjithmonë e më shumë po përdorin mjete elektronike të pagesave në përditshmërinë e tyre. Duke analizuar nga numri i transaksioneve “pagesa me karta” në treg vihet re një rritje prej 21.25% në numër dhe kjo metodë mban peshën kryesore prej afërsisht 62% ndaj totalit të instrumenteve të pagesave. Mendoj se kjo rritje e shpejtë e tyre ka ardhur si rezultat i disa faktorëve. Ndër më kryesorët mund të përmend faktin që bankat i ofrojnë kartat si instrument pagese prej shumë vitesh dhe pajisja e klientëve me karta ka ndryshuar sjelljen konsumatore, duke i shtyrë



ata drejt përdorimit më të gjerë të kartave për pagesa sesa thjesht për tërheqje cash në ATM. Sigurisht, kjo nuk është një sjellje e rastësishme, ajo ka evoluar me vetë procesin e ofrimit të produktit të kartave dhe më tej, me edukimin e vazhdueshëm, si dhe konfidencën për përdorimin e tyre. Por sërish, trendi i pagesave me para elektronike në terminale POS ka një rritje të vogël prej 2.4% në numër dhe sfida ngelet e madhe.

Gjithashtu, vlen të përmendim që i gjithë ekosistemi dhe zhvillimet e mëtejshme në teknologji kanë mbështetur këtë sjellje konsumatore, duke e bërë këtë proces më të lehtë dhe të shpejtë për klientët. Tani klientët kanë akses më të lehtë në pagesat dhe llogaritë e tyre nëpërmjet platformave të Online Banking që bankat ofrojnë.

Më tej, rritja e ndërgjegjësimit për sigurinë e kartave dhe përdorimi i teknologjisë së sigurisë së informacionit është një faktor tjetër që ka rritur besimin e konsumatorëve në pagesat me kartë.

Sa po ndikon turizmi në nxitjen e bizneseve për të pranuar pagesa me kartë?

Tashmë është fakt që turizmi në Shqipëri këtë vit ka pasur një rritje eksponenciale dhe numri i turistëve që kanë hyrë në Shqipëri gjatë këtij viti ka qenë mjaft i lartë. Pikërisht, ky numër i lartë i turistëve ka qenë një faktor kyç në rritjen e pagesave me kartë, gjë që ka nxitur bizneset të pranojnë pagesa me kartë, pra rrjedhimisht të pajisen me POS-e. Kjo është vënë re dhe nga kërkesa e rritur e bizneseve për POS-e, si dhe nga rritja e përdorimit të tyre krahasuar me periudhat e kaluara.

Turistët parapëlqejnë të përdorin kartat për pagesa, duke qenë se vijnë kryesisht nga vende ku cash-i përdoret gjithnjë e më pak dhe për çdo pagesë, qoftë edhe në përditshmëri përdoren kartat. Kjo është arsyeja pse bizneset turistike prirën të ofrojnë këtë shërbim, i cili tashmë duket se është kthyer në domosdoshmëri, me qëllimin për të ofruar lehtësi dhe një shërbim të mirë për klientët.

Sa janë aktualisht kostot e pranimit të pagesave me POS për bizneset? Vlerësoni se kostot mund të jenë një faktor që frenon potencialet e rritjes së pagesave me kartë bankare dhe cilat mund të jenë rrugët për uljen e kostove për bizneset?

Kostot e biznesit për pranimin e pagesave me POS variojnë nga 2% në 2.5% në nivel transaksioni dhe mund të ndryshojnë në varësi të shërbimeve dhe biznesit. Dhe, në fakt, kjo kosto është një objekt diskutimi si për bankat, edhe për klientët, duke qenë se ka kosto për të dyja palët.

Për bankat, biznesi i kartave dhe pagesave në POS ka kosto shumë të larta procesimi dhe sigurisht bankat jo gjithmonë ose pothuajse asnjëherë nuk e mbulojnë këtë kosto me çmimet që u ofrojnë bizneseve për pagesat në POS, dhe kjo sepse e shohin shumë të rëndësishme vetë marrëdhënien me biznesin. Prandaj dhe kjo situatë çon në një stepje të bankave për të zhvilluar më shumë këtë instrument

pagesave. Kjo gjë mund të vihet re dhe në saturimin që ka ky treg, ku vetëm pak banka kanë pjesën dominuese të POS-eve në treg.

Përveç kostove, a mund të identifikoni faktorë të tjerë që frenojnë një zgjerim më të madh të pagesave me kartë?

Po besoj se përveç kostove, që janë faktori kryesor për bankat dhe bizneset, ka edhe faktorë të tjerë që lidhen me mënyrën se si bizneset operojnë prej vitesh në një ekonomi ku mbizotëron cash-i. Kështu, përshtatja e tyre në menaxhimin e cash në mënyrë elektronike do të kërkojë pak më shumë kohë. Më tej, mendoj se dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm që vlen të theksohen në këtë aspekt janë:

- Mungesa e infrastrukturës së kartave, e cila ndikohet dhe nga teknologjia e komunikimit në Shqipëri. Në disa zona apo vende, ende mund të ketë mungesë të infrastrukturës për pagesat me kartë.
- Mungesa e edukimit financiar, ku një pjesë e mirë e njerëzve nuk kanë informacionin e duhur dhe të mjaftueshëm për të kuptuar avantazhet e pagesave me kartë.
- Rregullatorët dhe politika të kufizuara, ku politika dhe nisma të qeverisë mund të ndikojnë në nxitjen e pagesave me kartë.
- Mungesa e switch-it kombëtar, që do ulte kostot e procesimit në kartat vendase

Një segment i veçantë i pagesave me kartë janë ato nëpërmjet POS-eve virtuale/internetit. Vëreni rritje në këtë segment dhe si po ndërthuret ky shërbim me zhvillimin e tregtisë elektronike në Shqipëri?

Rritja në segmentin e pagesave me kartë nëpërmjet POS-eve virtuale/internetit lidhet ngushtë me rritjen e tregtisë elektronike në Shqipëri. Tregtia elektronike ofron mundësi të mëdha për pagesa online dhe POS-et virtuale janë një pjesë e rëndësishme e kësaj infrastrukture. Këtu mund të veçoj dy aspekte:

Lehtësia e pagesave online: Konsumatorët shqiptarë po priren më shumë për të blerë produkte dhe shërbime në internet, dhe POS-et virtuale ofrojnë një mënyrë të sigurt dhe të lehtë për të kryer pagesat.

Ndikimi i pandemisë: Pandemia e

COVID-19 ndikoi mjaft në rritjen e tregtisë elektronike, duke nxitur më shumë biznese të ofrojnë mundësinë e pagesave online.

Megjithatë, mund të shtoj që jemi ende në hapat e parë të mundësisë së pagesave online, e lidhur kjo dhe me natyrën e bizneseve të tregtisë elektronike dhe imazhit që duhet të forcojnë në treg.

Banka e Shqipërisë ka vendosur ndër objektivat e radhës në fushën e pagesave zbatimin e sistemit të pagesave të çastit (instant payments). Në çfarë faze është ky projekt dhe kur besoni se bankat mund të fillojnë të ofrojnë gjerësisht shërbimet e pagesave të çastit?

Projekti Instant Payment, ashtu siç dhe është diskutuar gjerësisht është pjesë e Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël (2018-2023) dhe mund të konsiderohet dhe si një rrjedhë logjike e zhvillimeve të nevojshme në treg pas Ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe zbatimit të banking-ut të hapur (open-banking) siç ndodhi edhe në tregun europian. Banka e Shqipërisë, në nëntor të vitit 2022, në mbledhjen e radhës të Komitetit Kombëtar të Pagesave prezantoi mënyrën se si ishte ideuar ky projekt dhe mënyrat e zbatimit të tij, bazuar në një studim fizibiliteti të hartuar në bashkëpunim me Bankën Botërore.

Megjithatë, nga komunikimet publike më të fundit të Bankës së Shqipërisë vlerësohet se nevoja e krijimit të një sistemi instant payment, përtej nevojave të tregut vendas, ka marrë dhe një dimension rajonal, në kuadër të projektit rajonal “Për modernizimin e sistemeve të pagesave në Ballkanin Perëndimor”.

Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë është duke bashkëpunuar ngushtë me Bankën Botërore dhe banka të vendeve të Bashkimit Europian për realizimin në periudhën afatmesme të këtij projekti.

Projekti i pagesave të çastit (Instant Payment) është një hap i rëndësishëm drejt modernizimit të sistemit financiar në Shqipëri, gjë që do të çonte në ulje të mëtejshme të kostove të pagesave në Shqipëri.

Si do të ndikojë zbatimi i instant payments në shërbimin e pagesave me kartë? Sa i

vështirë mund të jetë kapërcimi teknologjik nga pagesat me kartë te koncepti “nga llogaria në llogari” për përdoruesit e shërbimeve të pagesave?

Ashtu siç u përmend edhe më lart, projekti Instant Payment është pjesë e një strategjie, e cila synon krijimin e një tregu modern e gjithëpërfshirës të pagesave me vlerë të vogël, të mbështetur nga infrastruktura të sigurt dhe efikase, si dhe nga një gamë e gjerë instrumentesh dhe shërbimesh të pagesave që përmbushin nevojat e përdoruesve të tyre, të aftë financiarisht, në të gjithë vendin, me qëllim përfundimtar rritjen e përfshirjes financiare dhe përdorimin e pagesave elektronike.

Në këtë kuptim, hapësirat për të promovuar mënyra të ndryshme të pagesave elektronike, duke përmendur këtu kartat dhe pagesat e shpejta janë të shumta në kushtet e një tregu ku si përfshirja financiare ashtu dhe përdorimi i pagesave elektronike, është i ulët. Pavarësisht se në pamje të parë duket sikur do të ketë një kani-balizim të instrumenteve, vlerësoj se këto dy lloje instrumentesh mund të bashkërendohen në mënyrë optimale në tregun vendas dhe njëkohësisht, për shkak të konkurrencës, të rrisin dhe efikasitetin e tregut.

Kjo e parë edhe nga eksperiencat e vendeve të Bashkimit Europian, por dhe në rrafshin ndërkombëtar, ku gjithnjë e më shumë po operohen sisteme të tilla.

Nga ana tjetër, në lidhje me kapërcimin e teknologjive mendoj se për përdoruesin fundor, një ndryshim i tillë nuk është edhe aq problematik, pasi në vend të kartës fizike do të duhet të përdorë celularin dhe një aplikacion bankar online. Megjithatë, vlen të theksohet se me inovacionet që po përjeton industria e kartave, dhe dematerializimit të tyre në celular, siç është praktikë normale në tregjet e zhvilluara kjo diferencë do të zvogëlohet gjithnjë e më shumë.

Nga pikëpamja e bankave, mendoj se nuk bëhet fjalë për zëvendësim, sesa krijimi i një kanali të ri për kryerjen e pagesave, i cili duhet theksuar se do të fillojë që me prezantimin e open banking dhe shërbimeve të inicimit të pagesave. Në këtë kontekst, instant payment thjesht do të mbyllë ose do të plotësojë ciklin e zhvillimeve infrastrukturorë për kryerjen e transfertave elektronike. ■